

LIGJ
Nr. 53/2015

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9870, DATË 4.2.2008, “PËR
STANDARDIZIMIN”, TË NDRYSHUAR¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,
KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9870, datë 4.2.2008, “Për standardizimin”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:
Neni 1

Në nenin 8 bëhen këto ndryshime:

a) Pika 3 shfuqizohet.

b) Në pikën 4, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Marrëdhëniet e punës së Drejtorit të Përgjithshëm dhe nëpunësve të DPS-së rregullohen sipas legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen me Kodin e Punës.”.

Neni 2

Në nenin 14, shkronja “g” shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 21.5.2015

Shpallur me dekreten nr. 9121, datë 28.5.2015, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

NDREQJE GABIMI

Në vendimin e KQZ-së nr. 226, datë 7.5.2015 "Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 83, datë 25 maj 2015, faqe 4392 :

Ishte: OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z.Ardjan Turku.

Bëhet: OBJEKT: Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit, kandidatit të listës shumëemërore të Partisë Demokratike, në qarkun Shkodër, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë, pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj.Voltana Ademi.

¹ Ky ligj është përfaqësuar pjesërisht me Rregulloren (BE) nr.1025/2012 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 25 tetor 2012, “Mbi Standardizimin Europian”, që amendon direktivat e Këshillit 89/686/KEE dhe 93/15/KEE dhe direktivat 94/9/KE, 94/25/KE, 95/16/KE, 97/23/KE, 98/34/KE, 2004/22/KE, 2007/23/KE, 2009/23/KE dhe 2009/105/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit dhe që shfuqizojnë vendimin e Këshillit 87/95/KEE dhe vendimin nr.1673/2006/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit. Numër CELEX 32012R1025, Fletoria Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, Nr.316, datë 14.11.2012, fq.12-33.